

Zgjedhja e një artikulli

Zgjedhja e artikullit për redaktim në Wikipedia mund të jetë sfidues, veçanërisht për redaktorët e rinj. Më poshtë i gjeni disa strategji që kanë përdorur të tjerët.

Çfarë e bën një artikull të mirë në Wikipedia? Para se të filloni të shkruani, mendoni se si strukturohet informacioni në enciklopedi, dhe se si ky stil i shkrimit mund të jetë i ndryshëm nga shkrimet e kaluara që keni bërë. Familjarizohuni me artikujt e Wikipedia-s brenda disiplinës tuaj akademike, të cilat mund të shërbejnë si udhëzues për llojet e seksioneve që pritet të kontribuoni.

Bëni



Zgjidhni një temë që ju e dini mirë por që është i përfaqësuar dobët në Wikipedia. Nëse mund të gjesh shumë burime për një temë, por jo shumë informacion mbi të në Wikipedia, kjo është tema ideale për t'u punuar.



Shikoni artikuj që konsiderohen si "cung" ose "fillestarë" në shkallën e cilësisë së brendshme të Wikipedia-s. Në faqen e diskutimit të artikullit nganjëherë mund të shihni vlerësimin e artikullit.



Para se të krijoni një artikull, hulumtoni temën duke e kërkuar në variante të ndryshme të titullit. Temat mund të jenë të shkruara me emër tjetër.



Nëse jeni duke përditësuar një artikull ekzistues dhe dëshironi të punoni në sandboxin (kutinë e provës) tuaj, kopjoni tekstin ekzistues në sandboxin tuaj. Është më mirë të përmirësoni punën e redaktorëve të tjerë se sa të rishkruani të gjithë artikullin.



Filloni me kuriozitetin tuaj. Nëse keni gjetur një fakt interesant në një burim të besueshëm, kjo është një pikë e mirë fillestare për hulumtimin e temës tuaj. Kjo do t'ju mbajë të motivuar ndërsa kërkon për burime shtesë për të shkruar artikullin tuaj.

Për më shumë:
www.wikimediashqip.org



Zgjedhja e një artikulli

Zgjedhja e një artikulli për Wikipedia mund të jetë një sfidë, veçanërisht për editorët e rinj. Më poshtë i gjeni disa strategji që kanë përdorur studentët e tjerë.

Mos bëni



Mos u përpiqni të përmirësoni artikujt mbi tema shumë të gjëra, si p.sh. "E drejta", ose artikuj që tashmë janë mirë të zhvilluar në Wikipedia, siç janë "Artikujt e mirë". Këto tema janë më sfiduese për t'u përmirësuar në mënyrë efektive.



Mos tentoni të përmirësoni artikujt në tema kontroverse, si p.sh. ngrohja globale apo aborti. Edhe redaktimet e mira në artikuj kontravers apo tema emocionale mund t'ju lënë të ndiheni të frustruar. Konsideroni të punoni në një seksion të një artikulli ekzistues për të sjellë më shumë detaje në një aspekt të veçantë të temës.



Mos punoni në tema që nuk mbulojnë nga burime të besueshme ose nuk kanë referenca të mjaftueshme. Do e keni shumë të vështirë dhënie referencave të nevojshme për të krijuar një artikull në Wikipedia.



Mos filloni artikujt me tituj që kanë qasje të esesë, si p.sh. "Efektet e krizës së fundit të kredive të këqija në ekonominë globale". Në vend të kësaj, filloni me diçka si "Kriza e kredive të këqija". Wikipedia është një enciklopedi, një burim për fakte. Esetë dhe shkrimet argumentuese nuk janë të përshtatshme.



Mos rishkruani artikujt ekzistues. Punoni me tekstin ekzistues duke redaktuar ose duke shtuar gjithçka që është e nevojshme për të ndërtuar një artikull më të mirë. Artikujt e ndërtuar në këtë mënyrë do të përfitojnë nga bashkëpunimi i redaktorëve.



Mos harroni të kontrolloni portalet tematike të Wikipedia-s për faqet që lidhen me disipinën tuaj. Shumë disiplina kanë portale në Wikipedia që listojnë artikujt që kanë nevojë për përmirësim. Portalet janë faqe që mirëmbahen nga wikipedianët, të cilat fillimisht shërbejnë si faqe hyrëse në enciklopedi. Ato bëjnë prezantimin përmbledhës të artikujve kryesorë të një lloji temash që i përkasin një fushe specifike.